

Prof. Dr. Dhori Kule është i punësuar me kohë të plotë pranë Departamentit Ekonomiks në Fakultetin e Ekonomisë Universiteti i Tiranës dhe mban titullin "Profesor Doktor" në ekonomi nga viti 1999. Ka një përvojë pune 39 vjeçare si pedagog dhe studiues në fushën e ekonomisë. Pas diplomimit në vitin 1982 në Degën Ekonomi Politike në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, për një periudhë dyvjeçare ka punuar si përgjegjës i Departamentit Ekonomik të Uzinës Mekanike të Naftës në Kuçovë dhe njëkohësisht si pedagog i jashtëm i Filialit të Beratit, ka kryer studimet pasuniversitare dhe ato doktorale në Ekonomi, "Roli i shtetit në Tranzicion", Universiteti i Tiranës. Gjithashtu studime pasuniversitare në Itali dhe Poloni e postdoktorale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë Ekonomiks, Financat Publike etj.

Ka marrë pjesë në shumë projekte studimore kombëtare dhe ndërkombëtare

Ka shërbyer në pozicione drejtuese si Përgjegjës i Seksionit të Mikroekonomisë (1993-1994), Zëvendësdekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Përgjegjësit të Departamentit të Ekonomisë (1994-1996), të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Kryetarit të Këshillit të këtij Fakulteti (1997-2008) dhe të Rektorit të Universitetit të Tiranës (2008-2016). Kryetar i Unionit të Ekonomistëve Mbarëshqiptarë (1998), anëtar i Bordit të Drejtorëve të Fondacionit të Edukimit Ekonomik të Rinjve (1995-2004), anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Kursimeve (1999-2003), këshilltar i jashtëm për çështjet ekonomike pranë Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit të Shqipërisë (2001-2004), kryetar i Këshillit të Statistikave (2006 - 2012), anëtar i organeve të zgjedhura të qeverisjes lokale dhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë në Nëntor të vitit 2011 deri në Dhjetor të vitit 2018.

Në bibliografinë e punimeve të tij numërohen mjaft artikuj shkencorë, të cilët janë botuar brenda dhe jashtë vendit. Prof. Dr. Dhori Kule është bashkëautor i disa teksteve mësimore, si "Hyrje në Ekonomi", "Ekonomi e Zbatuar" etj. Ai ka kryer specializime pasuniversitare në disa universitete evropiane e amerikane dhe ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Është autor i mjaft studimeve të karakterit ekonomik, si dhe është udhëheqës i shumë doktorantëve për tematika të zhvillimeve lokale e globale.

Mban titullin "Qytetar Nderi" i qyteteve Berat, Sarandë, Kukës dhe komunave Çair (Shkup) dhe Margegaj (Tropojë) për kontribute të veçanta në arsim dhe për komunitetin. Mban gjithashtu titullin "*Doctor Honoris Causa*" nga Universiteti "*Ismail Qemali*", Vlorë dhe nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze, zotëron atë italiane dhe ruse.

Nga viti 2016 dhe aktualisht ushtron detyrën e Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Anëtar i Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.